

# Pasqyrimi gjinor në emisionet prime-time të televizioneve shqiptare



Punoi: Emiljano Kaziaj, PhD

## **HYRJE**

Ky projekt ka marrë në konsideratë tre emisione që transmetohen në prime-time, në televizionet Top Channel, TV Klan dhe Vizion Plus, përkatësisht emisionet: Top Show, Xing me Ermalin dhe Real Story. Të tre emisionet prezantohen nga moderatorë burra. Në njërin prej tyre ka një bashkëprezantuese femër e cila ka funksion episodik, në drejtim.

Monitorimi është kryer në periudhën Prill-Qershor 2019. Në këtë studim u analizuan 26 seri në total nga të tre emisionet e marra në shqyrtim.

Përpara fillimit të procesit të monitorimit, 3 monitoruese të angazhuara në këtë projekt, janë njohur me formatin e raportimit, në mënyrë domethënëse dhe gjatë një sesioni të shkurtër trajnimi, kanë analizuar konkretisht një nga emisionet, duke e përdorur këtë përvojë si një test, për procesin e monitorimit të mëtejshëm.

### **Fokusi i monitorimit:**

Formati i monitorimit, ishte i njehsuar për të gjithë programet dhe kishte në fokus të matjes dhe analizës këto elementë:

- Pjesëmarrjen (në terma **sasiore**) të femrave në emisionet prime-time të televizioneve shqiptare.
- Pjesëmarrjen në terma **cilësorë** të femrave në emisionet prime-time të televizioneve shqiptare.
- Analizë krahasuese e **qasjes së moderatorëve** të këtyre emisioneve kundrejt të ftuarëve meshkuj dhe të ftuarave femra, konkretizuar me pyetjet që iu bëhen të dy grupeve.
- Analizë e diskursit të moderatorëve të emisioneve kundrejt femrave në program, konkretizuar me shprehi apo qëndrime të tyre.

### **Analiza dhe gjetjet e këtij studimi janë me interes të madh sepse:**

- Japin një pamje të qartë të pjesëmarrjes dhe aksesit të femrave në emisionet prime-time të televizioneve shqiptare dhe karakteristika të kësaj pjesëmarrjeje.
- Japin një pamje të qartë të mendësive ekzistuese për femrat në Shqipëri, të normalizuara dhe përforcuara nga narrativa e këtyre programeve.

- Përshkruajnë se në cilat tema apo fusha të diskursit publik, femrat janë më të predispozuara për t'u përshirë nga mediat në Shqipëri.
- Identifikojnë problematika strukturore të mediave në Shqipëri, përsa i përket çështjeve gjinore dhe trajnimit të femrave.
- Identifikojnë dhe japin shembuj për narrative seksiste, objektifikuese apo homofobe në emisionet prime-time në Shqipëri.

Si i tillë ky studim dhe raporti në veçanti, mund të japë një ndihmesë të madhe për të gjithë aktorët dhe institucionet që punojnë në këtë fushë, dhe janë të interesuar për përmirësimin e situatës.

## **PERMBLEDHJE E GJETJEVE KRYESORE TE STUDIMIT**

### **Pjesëmarrja**

- Gjithsej në 26 seritë e monitoruara të tre emisioneve, për këtë studim, kanë qenë 112 të ftuar. Prej tyre 33 kanë qënë femra dhe 79 meshkuj.
- Ka një pjesëmarrje dukshëm më të madhe të meshkujve sesa femrave në emisionet prime-time të televizioneve shqiptare.
- Pjesëmarrja e femrave është më e madhe në ato emisione që konsiderohen argëtim ose tema sociale (Xing me Ermalin dhe Top Show).
- Ka një mungesë të madhe të pjesëmarrjes së femrave në emisione që perceptohen se trajtojnë çështje me interes të madh politik dhe shoqëror.
- Nga 31 të ftuar në programin Real Story, gjatë periudhës Prill- Maj, 2019, vetëm 2 janë femra dhe 29 janë meshkuj.
- Analiza identifikoi një seri emisionesh të cilat mbajnë si titull emrin e një burri që është i ftuar në program (psh: Erion Veliaj, Sandër Lleshaj, Fatmir Limaj, etj). Në asnjë rast nuk ka një emision që mban si titull emrin e një gruaje, edhe kur kjo është e ftuar në një program me status më të lartë se të gjithë të pranishmit e tjerë.

### **Trajtimi**

- Nga monitorimi i programeve u identifikua trajtim jo i barabartë (edhe në kuptimin cilësor përveç atij sasior), për femrat dhe meshkujt pjesëmarrës në program.
- Zakonisht moderatorët ia japin fjalën të parëve burrave, edhe në rastet kur e vetmja femër është pjesëmarrëse, mes 4 apo 5 burrave.

- Burrat flasin më gjatë dhe ndërpriten më pak. E kundërta ndodh për gratë, të cilat ndërpriten më shpesh si nga moderatorët ashtu edhe nga burrat e tjerë nëpër panele.
- Vihet re nga monitorimi, sidomos në programin Xing me Ermalin, se burrat e intervistuar pyeten më së shumti për çështje profesionalizmi, apo përvoja të punës ndërsa gratë e intervistuar (edhe pse mund të jenë në të njëjtin profesion) pyeten më shumë për rolet e tyre si mama, bashkëshorte apo çështje të tjera që mund të perceptohen si femërore.

Fokus më të madh në analizë ka marrë emisioni Xing me Ermalin, edhe për shkak të materialeve, natyrës dhe mënyrës se si moderatori e ndërton narrativën e vet, në emision.

Në këtë program u identifikuan nga analiza:

- Një prani e madhe e narrativës me natyrë seksiste, objektifikuese dhe homofobe.
- Trajtim jo etik i femrave që janë pjesë e stafit të emisionit.
- Narrativë problematike përsa i përket grupeve vulnerabël, kryesisht atyre me fokus ekonomik.
- Moskonsideratë për të ftuarit dhe përdorim i prezencës së tyre për të krijuar 'skandale' që mund të sjellin më shumë vëmendje të audiencës.
- Përforcim i mendësive për rolet gjinore duke përforcuar role pozitive për burrat dhe role varësie për gratë, në familje dhe në shoqëri.
- Përforcim i mendësive homofobe.

## Xing me Ermalin- TV Klan

Përshkrim (siç shfaqet në faqen e programit)



### **XING ME ERMALIN**

*Talk-show nga Ermal Mamaqi. Te ftuar pikante, intervista plot humor, muzike LIVE, inserte filmike, surpriza dhe gallata.*

*Nje talk-show ku intervistat nderthuren me humor dhe lojra te moderuara nga Ermal Mamaqi. Cdo i ftuar vjen ndryshe ne syrin e publikut dhe gjithmone ne kendveshtrimin argetues dhe komik. Te ftuarit jane personazhet me te suksesshem te momentit ne fushat e artit, politikës dhe showbizit. Argetim pafund me te gjithe te ftuarit!*

### **Të dhëna të përgjithshme:**

Për këtë studim u monitoruan 9 emisione të programit Xing me Ermalin, përkatësisht në datat:

13 Prill 2019; 20 Prill; 27 Prill; 4 Maj; 11 Maj; 18 Maj; 25 Maj; 1 Qershor dhe 8 Qershor.

### **Vëzhgime:**

Nga një analizë e shkurtër që mund t'i bëhet përmbajtjes së emisioneve shohim se gjithsej në emision ka pasur 23 të ftuar, prej të cilëve 8 të ftuar janë meshkuj dhe 15 femra. Kjo është një gjetje interesante krahasuar me emisionet e tjera të monitoruara për këtë studim, ku në emisionet e natyrës politike apo të debatit ku trajtohen çështje me interes për shoqërinë si arsimi, shëndetësia, politika, aktualiteti, etj., shumica e të ftuarëve janë meshkuj. Në këtë emision, që sipas përshkrimit është më shumë i natyrës humoristike, shumica e të ftuarëve janë femra.

Por, edhe në këtë emision ka diferenca për sa i përket fushës prej të cilës vijnë të ftuarit. Të ftuarit meshkuj, për periudhën tonë të monitorimit janë nga fushat e: mjekësisë, artit (violinist), këngës, aktrimit dhe politikës (një kandidat për zgjedhjet vendore). Të ftuarat femra për periudhën e monitorimit i përkasin fushave: aktrim, prezantim televiziv, këngëtare dhe bota e spektaklit.

Diferenca qëndron që nëse për të ftuarit meshkuj nuk kufizohemi vetëm në botën e artit, për të ftuarat femra, ku kufizim është i dukshëm. Shumica e të ftuarave përzgjidhen nga ato fusha që perceptohen si të lidhura me femrat. Pasojat janë përforcimi i të menduarit për femrat (edhe të suksesshme), vetëm brenda këtyre fushave. Ndërkohë edhe kur një e ftuar, ka pasur karrierë në

botën e spektaklit, por për momentin ka një pozicion pune tjetër, (rasti i Valbona Selimllarit, e cila për momentin është pjesë e kabinetit të kryetarit të bashkisë), gjithë intervista fokuset vetëm në të shkuarën e saj si Miss, përvojat e saj me botën e televizionit dhe nuk thuhet asgjë për punë e saj që lidhet me qeverisjen vendore.

Emisioni ka një narrativë të theksuar seksiste e cila del në pah më shumë në pyetjet që drejtuesi iu bën të ftuarëve të tij. Shembuj të këtyre pyetjeve janë:

- Pacientet kur vijne i shihni me rroba banjo apo kështu... ?
- A u ve ndonje shenje atyre femrave se jane bere te gjitha njesoj?(pyetje nga facebook)
- Pse je kaq pjeshke?(pyetje nga facebook)
- Kur te vine femrat per te rregulluar hunden a u prish ndonje gje tjetere?(pyetje nga facebook)
- Ke thene qe keto femrat e sotme jane te papuna dhe kanë cante nga 1000 euro,ti i fut te gjitha femrat ne nje thes?
- A te pelqeu kjo goca?(Per kengetaren Olimpia). Per cfare eshte e pershtatshme Olimpia prsh?
- Tani do vij nje vajze te cilen mund ta bashkosh dhe kete me dike,ndonje nga Elbasani ke per Belinden? A i thamë gje *kësaj* qe po e fejojme?(per velinen)
- Ledina ti mendon se pjeshkë lind apo behesh?(pyetje nga velina)
- 30 here te thashë e bukur e merr si kompliment apo... ? Se kur thone eshte e bukur thonë qe nuk eshte e mire per këto gjerat e tjera.
- A ke ndermend te behesh si shoqet me silikon? (pyetje nga facebook)
- E konsideron veten pjeshke apo superpjeshkë? (pyetje nga facebook)
- Po Miss ke qene dhe Miss ke ngelur nga trute,akoma do paqe ne bote qe vetem ben emisione humanitare?
- Ngacmimi i djemve te sotem eshte shprehja je si pjeshke,ateherë cfare fruti perdornin per te te komplimentuar?
- (Prezantuesi i drejtohet zonjes se publikut pas nje sherbimi dentar)-Ti Qerime jo buke po ke per te ngrene dhe burrin.
- (Koment per velinen e emisionit)-Me prove nuk e kemi por me bese dime qe vetem lentet i ka te vetat.
- Meqe po flasim per salcice ,cfare mund te na thuash per jeten personale?(drejtuar te ftuares femer).
- Janë disa femra qe ngajne si burra.(koment i prezantuesit)
- Nderkohe qe shfaqnin disa foto te Flaka Krelanit prezantuesi komenton 'alamet kofshe' 'sa tu ka bo kofsha' (ne min 31:19).
- Prezantuesi i drejtohet te ftuarit Hasbi Kasaj, interesante kur e blen gruan 2 milion leke se kur e blen 100 mijë leke eshte turp i madh (Min 38:08).

Siç shihet nga këto pyetje, shumica e tyre janë me një natyrë të theksuar seksiste. Edhe pse disa prej pyetjeve iu atribuohen 'pyetjeve nga facebook'- të shikuesve,-përsëri fakti që këto pyetje zgjidhen për t'u bërë (nga një mori pyetjesh) dhe jo të tjera, tregon që ai që i përzgjedh pyetjet ka pikërisht këtë qëllim, që ato të jenë të kësaj natyre, ashtu siç janë edhe pritshmëritë e emisionit. Pyetjet nga shikuesit përdoren si metodë për të përligjur legjitimitetin e pyetjeve sesksite që bëhen edhe drejtuesi, duke dashur të japë idenë se edhe shikuesit e emisionit ndajnë të njëjtat interesa me të dhe të normalizojë kështu natyrën seksiste të pyetjeve që bëhen në emision.

Një tjetër element i dalë nga analiza është edhe fakti që nëse për të ftuarit meshkuj shumica e pyetjeve sillen rreth aspektit profesional të tyre, për të ftuarat femra, pjesa profesionale e tyre lihet jashtë. Ja një shembull për një grup pyetjesh për dy të ftuar, njëri mashkull e tjetra femër, të të njëjtit profesion:

**Për të ftuarin mashkull, pyetjet:**

- Si ka mundesi qe klikimet e kengeve te tua shkojne me miliona?As Metallica nuk kapin keto shifra
- Majk ti je apo s'je pjese e baba stars? Apo nuk ngaterrohesh me grupime politike?
- Si je njohur me Baba Stars?
- Cfare po ndodh me grupin Baba Stars, kush ka ngel tjetër pjese e grupit? Pse nuk merrni ndonje personazh te ri?
- Kush eshte ylli i grupit ti apo GetoAri? Kush nga ju merr me shume lek?
- Cfare deshire ke te behet djali yt kur te rritet?
- Cila eshte rreperja femer me e talentuar qe ka vendi yne sipas teje?

**Pyetjet për të ftuarën femër, të të njëjtit profesion, këngëtare:**

- Besoj ti vdes per Kosovaret?
- Sa kohe ke qe je me burrin?
- A e do akoma si ditën e parë burrin?
- Dmth nuk te eshte bere akoma burri si vella?
- Po si u njohet me bashkëshortin?
- Si eshte puna qe ju artistet merrni burra nga Kosova,çfare kanë Shqiptaret me pak?
- Si shtepiake qe je, sa pastruese ke?

- Duke qene se jeni shume mire nga ana 'lekore'(financiare) cfare dhurate te beri bashkeshorti qe te ka ngelur ne mendje?
- Merresh me biznes? Kam degjuar qe ke hapur nje sallon bukurie.
- Cilin nga femijet ke me te preferuar dhe kush eshte me i veshtire per t'u rritur?
- A flasin femijet shqip?
- Ledina ti mendon se pjeshkë lind apo behesh?(pyetje nga velina)
- Mund te themi qe ke qene pak ekstravagante ne veshje, aman te festivali veshja jote transparente akoma flitet,mos ndoshta ajo veshje ishte e tejdukshme si mesazhi qe donte te jepte festival ii Rtsh per transparenc?
- Ca te tha burri kur u ktheve nga festivali?

Edhe pse duhet thënë që këngëtarja e ftuar, ka disa kohë që është larguar nga Shqipëria, përsëri nëse i bëjmë një analizë narrative pyetjeve për të kuptuar fokusin e tyre, duket që interesi i drejtuesit të emisionit është ta shohë mashkullin këngëtar si një profesionit,ndërsa femrën këngëtare si një grua, të një burri apo mama të fëmijëve, duke lënë komplet në hije çdo lloj ideje apo mendimi që kjo mund të ketë për muzikën apo profesionin e saj.

Analiza e pyetjeve na nxjerr në pah edhe rolin që luan drejtuesi i emisionit, apo edhe përmbajtja e këtij emisioni në tërësi për të përfocuar disa role gjinore të caktuara që duket se janë çimentuar në shoqërinë shqiptare (dhe jo vetëm) por që japin disa perceptime negative për rolin e gruas në shoqëri apo familje. Sidomos përsa i përket marrëdhënieve në famije, disa nga këto pyetje e vënë theksin tek roli parësor i burrit dhe ai dytësor, i gruas:

Shembuj të këtyre mund t'i gjejmë tëk seria e pyetjeve më poshtë:

- Ke thene qe je nje nuse tradicionale, a ja lan kembet burrit?
- Si cdo mama shqiptare a ja ke gjetur nusen djalit?
- Juve vajza nuk keni turp qe putheni me burrat e botes?
- A u gezuan familjaret (kur u martove) se ndonjeherë njerëzit martohen per familjen ne keto kohe, mos ndoshta po e ben per familjen?
- Nese do jetoje me vjerrit ne te njejten shtepi pas martese a do e puthesh burrin ne sy te tyre?
- Nese do jetoje me vjerrit ne te njejten shtepi pas martese si do ja besh me zhurmat e nates?A do krijosh zhurma brenda ne shtepi?
- Nqs kap biseda mes burrit dhe femrave te tjera cfare do i varesh burrit ne balle?
- Ciles nga ju i ka pelqyer i dashuri i tjetres?
- Cfare pretendimesh kane këta te shtepise per dhëndrin?



- Nderkohë që ftoi velinen për të bërë pyetjen të ftuarave (në min e 45:22), prezantuesi komenton se edhe Belinda është beqare dhe se *femrat e bukura janë të mbetura në derë*.

Pyetje të tilla, edhe pse duken si 'të pafajshme' dhe në efekt të humorit, në fakt përforcojnë disa perceptime që i vendosin gratë në pozicione inferiore brenda familjes dhe duke i pranuar si normale (pra duke i bërë pjesë të pyetjeve, pa pasur një qasje kritike dhe shpjeguese për publikun), moderatori edhe i normalizon të tilla perceptime. Kështu shprehjet më sipër janë ndërtuar mbi besimet e ngurtësuara shoqërore në lidhje me gratë si psh: nuset tradicionale duhet t'i lajmë këmbët burrave të tyre; djemve shqiptarë duhet t'jua gjejë nusen mamaja; nuk duhet të puthesh me burrin apo gruan tënde në sy të prindërve të tu etj. Edhe pse qëllimi i moderatorit mund të jetë që të krijojë situata komike më këto lloj shprehjesh, në fakt ato dhe përgjigjet e tyre prezantohen brenda një kornize normale interviste dhe nuk bëhet punë e mjaftueshme-sidomos nga moderatorit- për të theksuar kotësinë e këtyre mendësive.

Emisioni ka edhe një natyrë të theksuar homofobike. Në një rast të veçantë, me njërin prej të ftuarëve shumica e pyetjeve apo komenteve që bëheshin, kishin si qëllim për të vënë në pikëpyetje orinetimin seksual të të ftuarit.

Seria e pyetjeve/komenteve drejtuar të ftuarit, që janë më natyrë homofobike:

- Neve nuk na duhen drejtorlleqet ne na duhet a ke çpuar ndonje bythë Valer? (duke marrë parasysh që i ftuari ka profesion mjek, bëhet kjo lojë fjalësh)
- A behet ndonjehere xheloze gruaja jote qe je me pjeshke se ajo?(pyetje nga velina)
- A te ngacmojne meshkujt?
- Eshte i vertete thashethemi qe ke lene gruan shtatezanë? Si ndodhi?
- Tani qe do behesh prapë babë do heqësh dore nga sherret dhe nga këto zhveshjet?
- Ku i heq vetullat aq bukur?(pyetje nga facebook)
- Pse sillesh pak si femër?(pyetje nga facebook)

Sërish drejtuesi i emisionit i përdor pyetjet nga facebook (shikuesit) si mënyrë për të përçuar idenë e vetë apo mesazhin që do të japë.

Edhe në lojën që moderatorit ka zgjedhur pë të kryer me të ftuarin, gjithë narrativa në lojë ka një fokus të theksuar seksual, që prapë përpigjet t'i mëshojë dhe të krijojë perceptime për orientimin

seksual të të ftuarit. Loja është e tipit 'Plotëso fjalinë', ku disa fjalë lihen bosh dhe i ftuari duhet të gjejë apo shkruaj fjalët që mungojnë. Fjalitë që kanë zgjedhur t'i prezantojnë të ftuarit janë:

Kur ..... shumë, lagem mes kofshëve nga.....

Një shoku im më futi... dhe tani dua çdo ditë....

Më shpëtoi një ....aq e madhe sa m'u çanë ....

Duhet theksuar që edhe prezantuesi merr pjesë në lojë, me fjali të së njëjtës natyrë si për të mos e lënë të ftuarin vetëm në këtë përvojë, por gjithsesi fokusi është tek përgjigjet e të ftuarit dhe jo të moderatorit.

Duhet përmendur edhe fakti që prezantuesi duket që e ka ftuar gruanb e personazhit në emision, thjesht si një shtesë në funksion të idesë që ka pasur për të plotësuar figurën e të ftuarit mashkull. Kjo është e thënë në mënyrë eksplicite nga moderator i programit i cili shprehet se 'të kemi ftuar për të folur për tët burrë, kështu që do merremi me të'. Gjithashtu një fakt i tillë është i dukshëm që në pyetjen e parë që drejtuesi i emisionit i bën të ftuarës, kur e pyet 'Me se merresh, cfarë bën si profesion', gjë e cila të bën të mendosh për mosvëmendje ndaj të ftuarës dhe që prania e saj në emision është thjesht si një shtesë.

Përveç këtij rasti, specifik, edhe me të ftuar të tjerë, drejtuesi i emisionit ka bërë në disa raste komente homofobike, me pyetjet e tij të drejtpërdrejta, me qëndrimet ndaj përgjigjeve të të ftuarëve, apo me mosvepriemt e tij në raste të komenteve të pastra homofobike. Shembuj të këtyre pyetjeve janë:

- Prezantuesi i drejtohet te ftuarit mashkull-janë shtuar shume këta,po na ngacmojne shume meshkuj,large qofte te isha une.
- Në min 16:10 pas pyetjes se bere nga velina per Valbona Selimllarin-A ke puthur ndonjehere ndonje femer? E ftuara reagoi me nje lloj dridhje fizike qe mund te nenkuptohet si e papranueshme dhe tronditese si veprim (puthja me nje femer)dhe thote se JO. Prezantuesi qesh,dhe thote: **I foli gjuha e trupit(per te ftuaren)duke perdorur fjalen LARGE QOFTE .**
- (Pasi e pyeti doktor Skerdi Farian nqs bente ndryshim gjinie dhe ai tha jo) prezantuesi u shpreh-**Rendesit ka qe nuk behet** prandaj shkoni aty ku behet.

Në një prej serive (program i datës 8 qershor, ku e ftuar ka qenë Valbona Selimllari) ka pasur një narrativë diskriminuese nga moderator i emisionit për përkatësinë sociale dhe ekonomike, ku përforcohen mendësi negative ndaj kategorive në nevojë:

(Min 39:05)Prezantuesi tregon rastin e një familje të përmytur ndihmuar nga kisha. Pastori i kishte dhuruar një kolltuk dysh dhe një tresh një familjeje dhe personi i cili kishte marrë ndihmat kishte akuzuar Pastorin se i kishte marrë kolltukun të cilin mendonte se ishte pjesë e setit. Prezantuesi shprehet –**Se duhet thënë që këta njerez nuk janë të një niveli të lartë intelektual.**E ftuara i përgjigjet se ka raste që këta janë mosmirënjohës. Deri në min 41:20 flasin për raste individësh vulnerabël dhe me kushte ekonomike të vështira që gënjejnë dhe nuk janë mirënjohës ndaj ndihmës që u jepet.Prezantuesi sërish në min 41:21 thotë se: **Me këta njerëz duhet bërë ndonjë gjë, që nga niveli i të mësuarit se si duhet te sillen dhe se si duhet të mendojnë sepse ti i ndihmon pastaj ata shkojnë prapë te niveli zero.**

Duhet theksuar se shprehje të tilla nuk janë tendencioze nga moderatori, por si pasojë e injorancës dhe thjeshtimit që ai mundohet t'i bëjë, çështjeve delikate ekonomike dhe pasojave që ato kanë tek një pjesë e popullsisë.

Përsa i përket përkatësisë krahinore,ka pasur disa shprehje që mund të konsiderohen si diskriminuese, sidomos me të ftuarin që vinte prej veriut të Shqipërisë. Moderatori shprehet:

- Ja dhe një malësor tjetër që thotë Bravo! Bravo!
- Përveçse doktor je dhe malësor dhe si i tillë a gjuajte me pushkë kur lindi djali?
- Si malësor që je pse nuk lë mustaqe dhe ti dredhësh?

Një tjetër aspekt i këtij emisioni është edhe trajtimi që drejtuesi i emisionit i bën velinës, apo këngëtares së emisionit. Në disa raste gjuha e përdorur ndaj tyre është një gjuhë e pastër seksiste dhe objektifikuese. Shembujt:

- (pyet një të ftuar mashkull)- A të pëlqeu kjo goca?(për këngëtares Olimpia)
- Për çfarë është e përshtatshme Olimpia prsh?
- Tani do vi nje vajze te cilen mund ta bashkosh dhe kete me dike,ndonje nga Elbasani ke per Belinden?
- A i thamë gje kësaj qe po e fejojme?(per velinen)
- Ta marr hopa ta nxjerr perjasht (prezantuesi per velinen),-me shpulla plako(pergjigjet i ftuari mashkull)
- (Koment per velinen e emisionit)-Me prove nuk e kemi por me besë dimë qe vetem lentet i ka te vetat.
- **Pa tualet duket .... -duket me mirë me tualet** (komentet e prezantuesit per velinen e programit)
- Ne min e 49:00 prezantuesi mundohet te intimidoj velinen e emisionit (bashkepunetoren e tij) duke thene **se eshte prova e trete qe ajo bene, per te bere vetem nje pyetje te thjeshte.** Pasi e ftuara i thote te mos e vendosi ne siklet velinen a i pergjigjet (sipas tij me humor): **Ne nuk vëmë në siklet po thyejmë shishet në kokë.**

- Nderkohë qe prezantuesi ftoi velinen per te shpjeguar lojen e rradhes (ne min 1:22:22) prezantuesi komenton se **Belinda eshte thjesht e bukur, nuk eshte se ka bere ndonje gje tjeter.**

Kjo ndodh edhe me anëtarë të publikut:

- (Prezantuesi i drejtohet zonjes se publikut pas nje sherbimi dentar)-Ti Qerime jo buke po ke per te ngrene dhe burrin.

Ndërkohë interesante për t'u analizuar është edhe roli që i jepet velinës për pyetjet që duhet t'iu bëjë të ftuarëve. Natyra e këtyre pyetjeve, e përforcon edhe mënyrën se si publiku duhet ta shohë figurën e saj thjesht si një vajzë e bukur, por jo me shumë zgjuarësi, diçka e cila sugjerohet herë pas here edhe nga drejtuesi i emisionit nëpërmjet komenteve që përmendëm edhe pak më sipër. Ja disa shembuj të pyetjeve që pyet velina e emisionit:

- Majk kur e ke bere per here te fundit cicin ne krevat?
- A behet ndonjehere xheloze gruaja jote qe je me pjeshke se ajo?
- Ledina ti mendon se pjeshkë lind apo behesh?(pyetje nga velina)
- Pyetja ime me spec eshte: A ke puthur ndonjehere nje femer (për një të ftuar femër)? A mund të kem une ekskluzivitetin të jem e para?
- A e le burrin te vij te me ndërroj pak llampen ne shtepi se me eshte djegur?

## 1- Real Story, Sokol Balla, Vizion Plus

**Përshkrim** (siç shfaqet në faqen e programit)



*Formati kryesor politik në prime time në Vizion Plus, ideuar dhe moderuar nga gazetari i njohur Sokol Balla, nje tjetër sfidë ambicioze për gazetarin e njohur, i cili ka një përvojë të gjatë menaxheriale në fushën e informacionit. Çdo të hënë dhe të enjte në orën 21.00, gazetari Balla sjell për publikun temat më aktuale dhe më të forta për publikun, duke gjeneruar debat, ide, intervista, diskutime, brenda dhe përtej lajmit. Në këtë kohë të lajmit të rremë, përpjekja e re gazetareske e Ballës do jetë në funksion të reales dhe të vërtetës.*

*Gjithçka do të zhvillohet në nje studio të re e të hapur për të gjithë, e cila do të ofrojë thellësinë e analizës por edhe do të plotësojë nevojën e opinionit publik për zbardhjen e pikëpyetjeve të shumta të realitetit shqiptar.*

### **Të dhëna të përgjithshme:**

Për këtë studim u monitoruan 8 emisione të Real Story, përkatësisht në datat: 15 Prill 2019, 22 Prill, 29 Prill, 9 Maj, 16 Maj, 20 Maj, 23 Maj dhe 30 Maj 2019.

Temat që janë trajtuar në emision (siç shfaqen në tituj gjatë secilit emision):

- Kosova
- Partia e re
- Opozita
- **Fatmir Limaj**
- Zgjedhjet Europiane
- **Bamir Topi**

Në total në programet e monitoruara ka pasur 31 të ftuar, prej të cilëve 29 meshkuj dhe vetëm 2 femra (ka pasur edhe një rast ku një e ftuar femër është kontaktuar me skype).

Në disa emisione ka pasur edhe 5 të ftuar dhe asnjë femër. Rrjedhimisht aksesi që kanë të ftuarat femra në këtë emision është totalisht i munguar.

Interesant është fakti që të dyja të ftuarat femra Arta Dade dhe Teuta Vodo, në emisione të ndryshme, janë ftuar për temat: Kosova dhe Zgjedhjet Europiane.

Asnjë nga temat nuk perceptohet si e lidhur me aktualitetin apo realitetin shqiptar, pra çfarë ndodh brenda në vendin tonë, por për të komentuar atë që ndodh jashtë Shqipërisë.

### **Vëzhgim:**

Edhe kur e ftuara në emision është vetëm një e ftuar femër, përsëri, drejtuesi i emisionit ia jep fjalën së pari njërit prej të ftuarëve meshkuj.

### **Emërtimi i të ftuarëve (Naming )**

Një nga elementët në narrativën e diskursit është edhe *Emërtimi*, pra mënyra se si iu referohemi personave përsa i përket titujve të tyre. Ka një diferencë të theksuar në mënyrën se si prezantuesi i emisionit i drejtohet të ftuarëve meshkuj dhe atyre femra:

Zoti president... përse ky libër, përse vendosët ta thyenit heshtjen pikërisht sot? ( pyetje drejtuar Bamir Topit)

(Pas pyetjes së dytë ndaj Bekim Çollakut, i drejtohet Arta Dades): Zonja Dade?

Të ftuarës grua i drejtohet thjesht me Znj,. Dade, edhe pse kjo ka mbajtur postin e ministres së jashtme që poashtu si presidenti është një titull që personi e mban edhe pas përfundimit të mandatit si ministër i jashtëm.

Në rastin e të ftuarës tjetër femër, pra dy gjithsej nga e gjithë seria e monitoruar prej 8 emisionesh, prezantuesi i emisionit thkson se e ka ftuar, jo për shkak të punës së saj apo pozicionit që mban por:

“Mirëmbërëma zonja Vodo, Sekretare e Marrëdhënieve me Jashtë e Partisë Socialiste dhe ish-Zëvendësministre e Drejtësisë. Por, këtu e thirrur gjithashtu edhe në cilësinë e votueses sot është e ftuar në cilësinë e votueses, pasi zonja Vodo ka shtetësinë belge...” .

Detaj përforcues është se në titra shkruhet: Teuta Vodo – votuese në Belgjikë. Në vend që të shkruhet posti aktual si sekretare e marrëdhënieve me jashtë.

Pra fakti që e ftuara është grua, ka mbajtur pozicione të larta drejtuese, ka përvojë politike dhe mund të kontribuoj në debat me gjithë përvojën e vetë, nuk theksohet si një element i rëndësishëm nga prezantuesi. Ai e vë theksin vetëm tek fakti që e ftuara ka një nënështetësi të huaj dhe kjo ndoshta e ndihmon atë të sjellë një risi në program apo një element shtesë. Ky ndoshta është edhe detaji pse kjo grua është zgjedhur të marrë pjesë në emision përkrah burrave të politikës.

## Gjetjet emisioni Top Show- Alban Dudushi

Përshkrim (siç shfaqet në faqen e programit)



**E martë, 22:00**

*Top Show është një program i formatit Talk Show, drejtuar nga gazetari Alban Dudushi.*

### **Të dhëna të përgjithshme:**

Për këtë studim u monitoruan 10 emisione të Top Show, përkatësisht në datat: 26 Mars 2019; 2 Prill; 9 Prill; 16 Prill; 23 prill; 30 Prill; 7 Maj; 14 Maj; 21 Maj dhe 28 Maj.

Temat që janë trajtuar në emision (siç shfaqen në tituj gjatë secilit emision):

- (Pa ) Siguria ushqimore
- Zjarri i Notre-Dame
- Lufta vazhdon
- Lufta vazhdon (II)
- Beteja per Evropën
- **Pakti per Universitetin**
- **Erion Veliaj**
- **Ministri i brendshëm**
- A mashtrojnë portalet?
- Dilemat e 30 Qershorit

### **Vëzhgime:**

Nga një analizë e shkurtër që mund t'i bëhet përmbajtjes së emisioneve shohim se në 4 prej emisioneve të këtij programi, nuk ka pasur asnjë femër të ftuar në program. Në dy prej tyre ka qenë të ftuar vetëm nga një personazh mashkull i lidhur me politikën: Erion Veliaj dhe Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj. Ndërkohë nuk ka asnjë emision ku e ftuar të ketë qenë vetëm një femër. Edhe në rastin e emisionit dedikuar Paktit për Universitetin ku ka qenë e ftuar ministrja e arsimit, Besa Shahini, ajo ka qenë e vetme përballë një paneli me 7 meshkuj.

Emisionet që nuk kanë pasur asnjë femër të ftuar në to kishin të bënim me këto tema: Lufta vazhdon (II); Dilemat e 30 qershorit. Duket se keto tema janë shumë të forta për të pasur prezencë të femrave në to.

Ndërkohë në asnjë emision nuk ka pasur prezencë më të madhe të femrave sesa të meshkujve. Gjithmonë meshkujt kanë qenë më të shumtë në numër.

Në total ka pasur 58 të ftuar në të gjithë emisionet e transmetuar në periudhën Prill- Maj, 2019.

Prej tyre, 42 kanë qenë meshkuj dhe 16 femra.

Interesant është fakti që dy prej emisioneve mbajnë si titull emrin e personazhit mashkull që është i ftuar, si në rastin e Erion Veliajt apo Ministrit të Brendshëm, Sandër Lleshaj. Ndërkohë nuk ndodh e njëjta gjë me ministren e Arsimit, Besa Shahini, emisioni në të cilin ajo është e ftuar kryesore, nuk mban si titull emrin e saj.